

PETANI LAW & TAX

Shpronësimet publike, kompensimi i drejtë dhe mbrojtja e të drejtës së pronës

Rëndësia e mbrojtjes ligjore të pronës

E drejta e pronës është e mbrojtur nga Kushtetuta dhe Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut. Në procesin e shpronësimit, parimet themelore që duhet të respektohen përfshijnë ligjshmërinë, proporcionalitetin, dhe kompensimin e drejtë dhe të plotë.

Në vitet e fundit, ka pasur një rritje të konsiderueshme të shpronësimeve për interes publik, duke i vënë pronarët përballë sfidave të reja. Kjo situatë kërkon një mbrojtje ligjore të fortë për të siguruar që të drejtat e individëve të respektohen dhe të mbrohen në mënyrë të përshtatshme.

Po, cilat janë sfidat që hasin pronarët gjatë procesit të shpronësimit?

Gjatë procesit të shpronësimit, pronarët shpesh përballen me vlera të ulëta kompensimi që nuk pasqyrojnë investimet dhe potencialin e pronës, mungesë transparence në procedurat administrative dhe shkelje të afateve ligjore.

Me rritjen e numrit të shpronësimeve për projekte publike dhe infrastrukturore, këto sfida bëhen edhe më të ndjeshme, duke rritur domosdoshmërinë për mbështetje ligjore të specializuar, që të sigurohet mbrojtja e të drejtave, kompensim i drejtë dhe respektim i plotë i ligjit

Shërbimet e Petani Law & Tax

Analizë ligjore

Shqyrtojmë çdo akt administrativ dhe vendim shpronësimi për të verifikuar ligjshmërinë, respektimin e parimeve kushtetuese dhe të ligjit “*Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik*”, si dhe për të identifikuar çdo shkelje procedurale që mund të ndikojë në të drejtat e pronarëve.

Shërbimet e Petani Law & Tax

Kundërshtim i vlerës së kompensimit

Përgatisim dhe paraqesim kundërshtime të vlerës (kërkesëpadi), duke siguruar që kompensimi të reflektojë vlerën reale të pronës, investimet e kryera dhe potencialin e zhvillimit, sipas standardeve ligjore dhe jurisprudencës kombëtare e ndërkombëtare.

Shërbimet e Petani Law & Tax

Këshillim dhe përfaqësim në procedura administrative dhe gjyqësore

Ofrim këshillimi ligjor në çdo fazë të procedurës, nga shqyrtimi administrativ deri te ankimi gjyqësor, duke garantuar mbrojtjen e të drejtave të pronarëve, respektimin e afateve ligjore dhe sigurimin e kompensimit të drejtë dhe të plotë.



ADRESE: LAGJJA Nr 3. Sheshi
Liria, Qendra e Biznesit Best Co,
kati i 11-të, pranë Bashkisë Durrës

Email: info@petani-lawfirm.com



STUDIO LIGJORE

PETANI

LAW & TAX

DURRËS - TIRANË - PRISHTINË - ITALI